



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2018, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 24 dhe 25 shtator 2018.
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, nismë e 37,527 zgjedhësve.
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Indrit Osmani - Drejtor Ekzekutiv i shoqatës “Animal Rescue Albania”

Jonel Kristo - anëtar i Bordit Drejtues i shoqatës “Animal Rescue Albania”

Ilir Bejko - Drejtor në Drejtorinë e Oponencës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Argita Alikaj - Përgjegjëse Sektori i Vlerësimit të projektligjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mamica Dhamo - Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nada Dollani - Eksperte e GIZ

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Të futen mediet brenda!

Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, meqenëse plotësohet kuorumi për të vazhduar mbledhjen.

Para se të fillojmë mbledhjen, në emër të kolegëve të Komisionit të Ligjeve, dua t'i uroj ditëlindjen koleges sonë Elena Xhina, e cila sot mbushi 40 vjeç.

Sot është data 1 tetor, dita e parë dhe java e parë e muajit, ndaj dua t'ju uroj muaj të mbarë!

Urimet më të mira, zonja Elena, dhe e kalofshi sa më mirë ditën sot!

Elena Xhina - Faleminderit!

Ulsi Manja - Sot në rend dite kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 24 dhe 25 shtator 2018.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

A ka komente? Nuk ka.

Miratohen.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, nismë e 37,527 zgjedhësve. Komisioni ynë është komision përgjegjës në shqyrtimin e kësaj nisme. Relator i kësaj nisme është kolegu Adnor Shameti.

Nga shoqata “Animal Rescue Albania” kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Indrit Osmani, drejtor ekzekutiv, dhe zoti Jonel Kristo, anëtar i bordit drejtues të shoqatës.

Të ftuar nga Ministria e Drejtësisë kemi zonjën Argita Alikaj.

A ka ardhur zonja Alikaj?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, zonja Alikaj, mund të zini vend!

Këtu kam të shënuar edhe praninë e zonjës Edona Vajushi, e cila nuk ka ardhur. I ftuari tjetër është zoti Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Atëherë, pa humbur kohë, duke qenë se kjo është një nismë ligjore e 37 mijë e 527 zgjedhësve, një prezantim të këtyre ndryshimeve do ta bëjë zoti Indrit Osmani, drejtor ekzekutiv i shoqatës “Animal Rescue Albania” ose kush të dëshirojë.

Do t’ju lutesha të na bënit shkurtimisht një prezantim të kësaj nisme, duke qenë se sot kemi vetëm shqyrtimin dhe miratimin në parim të kësaj nisme. Diskutimin nën për nën dhe miratimin në tërësi të kësaj nisme do ta kemi në mbledhjet e radhës.

Kjo është një nismë e rëndësishme dhe shumë sensitive. Këtë e tregon edhe fakti se janë 37 mijë e 527 zgjedhës, të cilët kanë dhënë mbështetjen e tyre për këtë nismë. Sigurisht, Komisioni i Ligjeve, duke vlerësuar rëndësinë e kësaj nisme, e ka përfshirë atë edhe në programin e punës së Kuvendit, por edhe në kalendarin e punës së Kuvendit. Kjo nismë kërkon 84 vota, por ka të gjithë vullnetin dhe mbështetjen tonë si maxhorancë. Dihet se ndryshimet në Kodin Penal kërkojnë 84 vota, ndaj është e nevojshme edhe mbështetja e opozitës lidhur me këto ndryshime që fillojmë sot në shqyrtim.

Fjala për ju.

Jonel Kristo – Zoti Manja, faleminderit për kohën!

Gjithashtu, dua të falënderoj të gjithë komisionin për mundësinë që na dha për të ardhur këtu! Unë ju garantoj se do të jem shumë konciz. Këtë gjë po i thosha edhe Indrit kur erdhëm këtu, që miratimi në parim i kësaj nisme e kemi kërkuar prej 14 vjetësh tashmë. Pa humbur kohë, po ju shpjegoj situatën, sepse është emergjente. Të gjithë na pyesin se çfarë e shkaktoi mbledhjen e 37 mijë firmave? Pse kaq shumë firma? Juristja jonë na shpjegoi se mbledhja e kaq shumë firmave për një kohë të gjatë vuri një precedent në parlamentin shqiptar, që qytetarët të sjellin një nismë të tillë në komision jo vetëm para jush, por në tërësi.

Për ata që janë kuriozë, unë mendoj se pamjet flasim më mirë se unë. Kështu që do t’ju lutesha të ndiqni vetëm dy minuta filmime, për të kuptuar se çfarë e shkaktoi marrjen e kësaj nisme vitin e shkuar. Videoja ka pamje grafike të rënda. Unë e kuptoj se është mëngjes dhe e di që zonja këtu feston ditëlindjen sot, por dua që ta shikojmë videon me kujdes. Kjo është videoja që, si të thuash, e derdhi gotën, e cila ishte e mbushur dhe na detyroi neve të sjellim këtë nismë para jush. Unë dua që ta shikoni me kujdes dhe ju paralajmëroj se pamjet grafike janë të rënda, por është ajo që na ka bërë neve të jemi këtu sot.

Ju kërkoj vetëm një minutë kohë për të parë videon.

(Po shfaqet një video)

Besoj se mjafton.

Ai mund të jetë një qen shoqëruar, por e njëjta rëndësi me këtë video janë këto dy pamje. Ky është një Rrëqebull i Ballkanit dhe është një specie në rrezik dhe kjo është Shkaba

jonë e famshme. Ndaj, sot mund të vrasësh 10 mijë të tillë po të duash, por, fatkeqësisht, nuk ekzistojnë kaq, mund të vrasësh 1 mijë arinj dhe maksimumi i dënimit që merr është një gjobë minimale. Ne duam ta ndryshojmë masën e dënimit për këtë gjë, sepse ajo që ne sapo pamë në këto pamje quhet krim. Sot asnjërit nuk i ndodh asgjë dhe atij që vrau atë kafshë nuk i ndodh asgjë. Në Palasë dikush i preu kokën një qeni të tillë dhe muaj më pas i preu kokën edhe nipit të tij. Po të kishim mundësi, që në momentin kur ky njeri i preu kokën qenit të tij, me masat që kemi propozuar këtu, ta ndalonim atë fenomen. Ne nuk ia arritëm dot, sepse ligji ka një vakum të tillë. Prandaj, do t'ia jap fjalën kolegut tim Indrit Osmani që të shpjegojë pse ne duam që ky fenomen të përshkallëzohet në një krim dhe jo thjesht në një shkelje.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Mund të vazhdoni zoti Osmani.

Indrit Osmani - Unë kam përgatitur shkurt dy fjalë në lidhje me nismën e qytetarëve. Ne, 37 mijë qytetarë, me të drejtë vote, vendosëm t'u drejtojmë të zgjedhurve tanë në Kuvendin e Shqipërisë një propozim në ligj për shtimin e disa neneve në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me objekt mbrojtjen e kafshëve nga dhuna dhe nga keqtrajtimi.

Vitin e kaluar ne u përballëm me një ngjarje, e cila mori vëmendje të madhe në opinionin publik, ku një djalë nga Kuçova masakroi pa mëshirë qenin e tij, ndërsa krimi u filmua dhe u shpërnda në portale. Kushdo që e ka parë atë video, i ka të ngulitura në mendje pamjet dhe kuisjet e qenit të mjerë derisa dha shpirt dhe të qeshurat e personit nga ana tjetër. Ky nuk është një episod i izoluar, pasi lista është shumë e gjatë.

Në mënyrë të vazhdueshme ne bëhemi dëshmitarë të dhunimit dhe vrasjeve të kafshëve pa asnjë shkak dhe bëhemi spektatorë të videove dhe pamjeve tejet të rënda të argëtimit me jetën e tyre. Ne kemi parë kafshë që helmohen çdo ditë me preparate, që çdo person, pa asnjë kontrolli, mund t'i blejë dhe mund t'i përdorë; kafshë që tërhiqen zvarrë me makinë; kafshë që hidhen nga ura për argëtim; kafshë që mbyten në lumë të lidhur me gurë, kafshë që rriten dhe stërviten për t'u ndeshur dhe për t'u vrrarë; kafshë që u pritët koka; kafshë që kapen në natyrë dhe mbahen në robëri për argëtim në kafaze lokalesh dhe hotelesh; kafshë në zhdukje që vriten pa asnjë shkak; dyqane që shesin kafshë në kushte të rënda higjienosanitare, ku shumica e kafshëve nuk arrijnë të shiten nga përhapja e viruseve të rënda dhe sëmundjeve vdekjeprurëse; ferma të shtimit dhe stërvitjes për ndeshje, e të tjerë.

Rasti i qenit të Kuçovës, është rasti që derdhi gotën e mbushur plot dhe shkaktoi një reagim shumë të madh në opinionin publik, i cili kërkonte, në radhë të parë, përshkallëzimin e veprimeve, duke i kërkuar Kuvendit të marrë masat e nevojshme. Brenda pak kohësh u bë

publike platforma e peticionit “Një ligj katër putra”, e cila u shpërnda në të gjithë vendin dhe u mbështet nga një solidaritet i paprecedent. Mbi 37 mijë firma u mblodhën brenda dy javëve për peticionin, ku kërkoheshin disa ndryshime në Kodin Penal, që vrasësit, përdoruesit, robëruesit e kafshëve të mbajnë përgjegjësi penale. Vetëm në ditën e parë të mbledhjes së firmave përpara godinës së seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë u mblodhën rreth 2000 firma qytetarësh, me të drejtë vote. Asnjëherë më përpara nuk janë bërë bashkë 37 mijë zgjedhës për të bërë një ndryshim kaq thelbësor. Do të jetë në nderin e këtij Kuvendi miratimi i këtyre dispozitave të dorëzuara nga 37 mijë zgjedhës të Republikës së Shqipërisë. Projekti dhe firmat u dorëzuan në parlament në nëntor të vitit 2017 dhe ne shpresojmë që një ditë ky projektligj do të kalojë pragun e derës së komisioneve dhe të miratohet, jo sepse duam ne, por sepse i duhet shoqërisë.

Këta individë që sot vrasin dhe torturojnë kafshë, nesër zgjedhin një njeri si viktimën e radhës. Votimi i projektligjit për disa ndryshime në Kodin Penal është i domosdoshëm dhe tepër i vonuar.

Zotërinj deputetë, unë kam marrë edhe një listë, të cilën e kam paraqitur edhe në dokumentacionin që kemi sjellë, ku janë të gjitha vendet e rajonit dhe të Europës, të cilat e kanë të parashikuar në ligj. Ne jemi vendi i fundit në rajon, i cili nuk ka parashikuar asnjë dispozitë në Kodin Penal apo një ligj të posaçëm për mbrojtjen e kafshëve. Për shembull, Gjermania e ka në preambulën e Kushtetutës së saj. Gjithashtu, Austria, Franca, Danimarka dhe Italia e kanë të parashikuar në dispozitat e Kodit Penal dhe Civil. Dispozitat që kemi punuar dhe paraqitur, të cilat më pas janë votuar nga qytetarët, janë shumë të ngjashme, për të mos thënë identike, me dispozitat e parashikuara në Kodin Penal italian. Por edhe shtete të tjera, si: Irlanda, Sllovenia, Spanja, Suedia, Finlanda, Estonia, Republika Çeke, Qipro, Bullgaria, Bosnja, Kroacia, Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Norvegjia, Islanda, Zvicra, Greqia, Lituania, Hungaria, Luksemburgu, Maqedonia e të tjera me radhë i kanë të parashikuara në ligj. Sigurisht që i kanë shumë më të detajuara se këto që kemi paraqitur ne, por mendojmë që si hap i parë është mjaftueshëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Prokuroria e Përgjithshme, a është njohur me nismën?

Kujtim Luli – I ndërruar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Projektligji për ndryshimet në Kodin Penal lidhur me veprat penale kundër mirëqenies së kafshëve, në parim e vlerësoj më të nevojshëm për plotësimin e ligjit me material penal, i

cili është në përqasje me standardet e akteve ndërkombëtare europiane dhe disa legjislacioneve të vendeve të Bashkimit Europian.

Në radhë të parë, çmoj se është e domosdoshme që në Kodin Penal të bëhen ndryshime dhe shtesa për disa vepra penale, për të parandaluar, mbrojtur dhe garantuar në mënyrë të posaçme si shëndetin e publikut nga sëmundjet e transmetueshme nga kafshët dhe lëndët mbetëse të dëmshme, që gjenden në produktet e tyre për konsum publik, ashtu edhe mjedisin nga infeksionet, helmet, mbeturinat, ndotjet e kafshëve me pasojë për shëndetin e kafshëve, por edhe të njerëzve.

Duke u nisur nga nisma e 37 mijë e 527 shtetasve, e formuluar në projektligjin me 6 dispozita të grupuara në kreun e 12-të, të emërtuara “Vepra penale kundër mirëqenies së kafshëve”, referuar edhe ligjit “Për shëndetin dhe shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 10465 i vitit 2011, në nenin 1 dhe 2 parashikon qëllimet dhe objektin e këtij ligji, janë parashikuar veprime të kundërligjshme, në kundërshtim me këtë ligj, edhe për mirëqenien e kafshëve. Gjithashtu, ka edhe dispozita të pjesa e kundërvajtjeve administrative që këto shkelje shkojnë deri në nivelin e kundërvajtjeve administrative. Kodi Penal në nenin 207 të tij ka një vepër penale lidhur me shkeljen e karantinës në lidhje me trajtimin e kafshëve. Nuk kemi vepra penale të tjera në Kodin Penal shqiptar.

Referuar legjislacioneve të vendeve të tjera, po i referohem Italisë nga i cili është huazuar pothuajse tërësisht drafti i paraqitur, në vitin 2010 Italia ka ratifikuar konventën europiane lidhur me mirëqenien e kafshëve dhe kafshëve të shoqërimit. Në vitin 2011 janë ndryshuar tërësisht dispozitat e Kodit Penal italian në lidhje me këto vepra penale që bëjnë fjalë për mirëqenien e kafshëve.

Ndërsa referuar legjislacionit të Kosovës, i cili është një legjislacion relativisht i ri dhe ka hyrë në fuqi në vitin 2013, kemi disa dispozita të veprat penale të mjedisit dhe kafshëve, në një kapitull të veçantë të Kodit Penal kosovar, por këto vepra penale, shkojnë më shumë në mbrojtje të interesave të shëndetit të njerëzve sesa të kafshëve.

Këtë nismë në parim ne e përkrahim dhe është një nismë që duhet të shkojë për plotësimin e Kodit Penal, por në vlerësimin tonë duhet të shkojë si paketë me të gjitha ndryshimet e tjera që shkojnë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luli!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, përpara se t’ia kaloj fjalën relatorit.

Ilir Bejko – Përshëndetje, zoti kryetar!

Ministria e Drejtësisë ka pasur shumë pak kohë për t’u njohur me këtë projektligj. Duke qenë se këtu bëhet fjalë për ndryshime në Kodin Penal dhe për masa shumë të larta dënimi,

deri në 3 vjet heqje lirie, do t'ju luteshim të na jepnit më shumë kohë për të dhënë një mendim më të argumentuar lidhur me këtë projektligj. Me aq sa kemi vlerësuar, siç e thashë, masa e dënimit me 3 vjet burgim është shumë e lartë. Ky projektligj është krahasuar edhe me legjislacionet e vendeve të tjera të Bashkimit Europian dhe ne sugjerojmë që të hartohet një ligj, i cili mbron kafshët dhe veprimet ekstreme në kundërshtim me këtë ligj të kalonin në Kodin Penal. Për shembull, në projektligj përmendet eksperimenti i jashtëligjshëm me kafshët, mund të hartohet një ligj për mbrojtjen e kafshëve, i cili jep një definicion të qartë për eksperimentin e ligjshëm dhe ajo që bie në kundërshtim me këtë të parashikohet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministria e Drejtësisë ka krahasuar parashikimet e këtij projektligji me ligjin penal gjerman dhe austriak. Dënime kaq të rënda në këto dy ligj nuk gjenden, prandaj do t'ju luteshim për më shumë kohë për të bërë një analizë më të detajuar lidhur me këtë projektligj.

Ulsi Manja – Të lutem, sot jemi për t'u shprehur në parim në lidhje me këtë projektligj, sepse ky projektligj ka nevojë t'i nënshtrohet një diskutimi dhe konsultimi të gjerë përpara se të shqyrtohet nën për nën dhe të miratohet në tërësi.

A jeni pro, apo jo në parim, për të pasur një iniciativë të tillë për ndryshime në Kodin Penal për me mbrojtjen e kafshëve? Ky është edhe qëllimi i mbledhjes së sotme.

Ilir Bejko – Natyrisht, torturimi i kafshëve duhet të jetë i parashikuar si një vepër penale në Kodin tonë Penal.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Shameti!

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo iniciativë ligjore është ndryshe nga të tjerat, pasi siç e sqaruan edhe propozuesit e projektligjit, bëhet fjalë për një iniciativë të ushtruar nga 37 527 shtetas. Në parim shpreh si relator, mbështetjen për miratimin e kësaj nisme ligjore.

Projektligji ka si qëllim dënimin e rasteve të dhunës ndaj kafshëve, duke parashikuar rastet konkrete të shkeljeve dhe sanksionet përkatëse. Projektligji përbëhet nga 6 nene, në të cilat janë parashikuar këto vepra penale: eliminimi i kafshëve me armë zjarri, braktisja e kafshëve të shoqërimit, tortura, helmimi e keqtrajtimi i tyre, organizimi i ndeshjeve mes kafshëve që shkaktojnë vuajtjen apo torturimin e kafshëve, kryerja e eksperimenteve të jashtëligjshme me kafshët, si dhe përdorimi i lëkurës së kafshëve të shoqërimit dhe individëve të faunës së egër në rrezik zhdukjeje. Përfundimisht, i propozoj komisionit miratimin në parim të projektligjit. Nisur nga konstatimi për domosdoshmërinë e rregullimeve për ta sjellë

nismën në standardet e teknikës legislative, do të paraqes propozime konkrete gjatë shqyrtimit nen për nen të kësaj nisme.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni zoti Fino!

Më pas e ka fjalën zoti Hyseni!

Bashkim Fino – Faleminderit juve, që e parashtruat projektligjin!

Unë e shoh këtë projektligj shumë interesant. Ajo që më bie më shumë në sy është se në të gjitha nenet që ju keni parashikuar, pra ato 6 nene, e kam edhe për relatorin, që është jurist, se ka 2 penalitete për çdo nen. Pra, ka edhe burg, edhe gjobë. Pra, në çdo nen thuhet se dënohet me burg 2-3 vjet, siç tha përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë dhe me gjobë 50-100 mijë lekë.

Ndërkohë, që në një nen tjetër shoh se tortura, helmimi apo çdo akt tjetër që sjell gjymtimin apo çdo dëmtim të përhershëm të kafshës dënohet me 2-3 vjet burg. Pra, një nen ka vetëm dënim, ndërsa të gjitha nenet e tjera janë të shoqëruara me 2 penalitete. Kjo do të thotë (nuk e di si e kanë vendet e tjera të BE-së), por kam përshtypjen se kur një njeri dënohet, nuk mund të dënohet me 2 penalitete. Kur ka një shkelje dënohesh sipas Kodit Penal, por nuk mund t'i thuash të bëjë 3 vjet burg dhe paguaj 3 milionë lekë gjobë. Këtë nuk është shënuar “ose”, por është shënuar “edhe, edhe”, pra edhe dënohet, edhe paguan gjobë.

Kisha edhe një sqarim për këtë çështje. Natyrisht, kjo është kur të vijë fjala te shqyrtimi nen për nen. Gjithsesi, në rast se ka mundësi të rregullohet...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Urdhëroni zoti Hyseni!

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Duke shprehur vlerësimin maksimal për nismën, se unë kam pasur shansin të bashkëpunoj me disa nga nismëtarët dhe në kuadër të dijenisë sime, që ka edhe një tjetër nismë ligjore të depozituar në Kuvend dhe besoj se në kuadër të diskutimeve do të ezaurohen për të dyja nismat. Dua të ftoj të gjithë kolegët që duke i kursyer vetes debatet për procesin në vijim të jenë dakord në parim dhe ta mbështesim si nismë. Unë mendoj se drafti ka shumë punë në lidhje me teknikën legislative.

Po ashtu, për masën dhe thellësinë e dënimit të veprave penale, por sot le të diskutojmë nëse jemi pro apo kundër në parim me këtë nismë.

Unë ju ftoj të jemi së gjithë bashkë pro kësaj nisme. Kjo nismë ligjore është domosdoshmëri. Ka arritur pika që është domosdoshmëri që në legjislacionin tonë penal të parashikohen dënimi penal për disa nga krimet makabre që bëhen ndaj kafshëve. Kemi qenë vetë dëshmitarë të shumë syresh.

Prandaj, duke i drejtuar kryetarit një sugjerim që të kihet në konsideratë që të dyja nismat të shqyrtohen paralelisht, ju ftoj ta miratojmë nismën!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj prezantuesit e nismës!

Unë nuk do të hyj në çështjet e teknikës legjislative dhe të shqetësimit që ngriti me të drejtë kolegu Fino, për pasjen e dy dënimeve, por unë kam një pyetje për propozuesit: A e keni vlerësuar mundësinë për të pasur një ligj për mbrojtjen e kafshëve dhe njëkohësisht, për të përcaktuar disa të drejta dhe detyrime si për ata që mbajnë kafshë në familje, si për komunitetin, për institucionet në nivel vendor apo qendror?

E dyta, ju përmendni një sërë veprimesh ose mosveprimesh, të cilat përbëjnë vepra penale ndaj kafshëve, ndërkohë që nuk shoh dispozita të tjera që, me sa kuptova nga kolegu Hyseni, synojnë të mbrojnë qytetarin nga veprimet e pronarëve që kanë kafshë, nga mënyra se si e mbrojnë dhe mbajnë pastër ambientin dhe format e tjera. A e keni parë këtë qasje tjetër?

E fundit, ju përmendët që ky është modeli italian. Nga studimi i modeleve që ju i keni bërë vendeve të tjera, a i kanë dhënë më shumë rëndësi mbrojtjes me një ligj të posaçëm, jopenal, apo i kanë dhënë më shumë rëndësi mbrojtjes penale? Pyes, duke marrë shkas edhe nga shqetësimi që ngriti me të drejtë përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë. Ka disa koncepte këtu, të cilat në qoftë se nuk janë të sqaruara diku, në një ligj, janë shumë të vështira për t'u përfshirë në Kodin Penal, për të kuptuar se kush është e ligjshmja dhe e paligjshmja, për të mos folur pastaj për disa forma që me sa kuptoj këtu, s'do të ketë më cirk kafshësh. Pra, ju jeni për mbylljen e cirkut, ku përdoren kafshët e ndryshme.

Po ashtu, me sa shoh ju nuk jeni dakord as me ndeshjet toreadorëve në Spanjë me dema, që transmetojnë mediet etj. Pra, shoh se ju vini disa barriera edhe për transmetimin e shfaqjeve, që kanë të bëjnë me kafshët.

Nuk e di a futen edhe këtu shfaqjet me delfinë etj. Shoh se keni kaluar jo thjesht në mbrojtjen reale të kafshëve, por edhe të pamjeve vizive dhe të të drejtës së transmetimit të filmave apo të shfaqjeve me kafshë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, për një përgjigje të shkurtër!

Jonel Kristo – Në lidhje me 2 pyetjet e para, që mendoj se kishin lidhje me njëra-tjetrën, mund t'ju themi se nga praktikatat europiane që kemi studiuar, pothuajse të gjitha vendet europiane (për të mos përmendur vendet kryesore si Gjermania, Franca, Austria, Italia, Holanda etj.), i kanë të parashikuara të dyja rastet, edhe dispozitat në ligjin penal, edhe një ligj të veçantë, të cilin mund t'ju kisha sjellë këtu. Ai i ka jashtëzakonisht të detajuara. Ne mendojmë se ndoshta është akoma herët për shoqërinë tonë që të pranojë ligje të tilla, sepse ato u japin shumë të drejta kafshëve. Pra, përgjigja është po. Këto vende kanë legjislacionin penal, edhe një ligj të veçantë për trajtimin e kafshëve. Mund t'ju them se sot në Gjermani nuk mund të adoptosh një qen apo kafshë së cilës i janë prerë veshët. Aq radikal legjislacioni atje, sepse ai e lidh çdo gjë me çfaqjen e dhunës ndaj kafshëve dhe me keqtrajtimin e kafshëve.

Për pyetjen e fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendoj se kishte lidhje me pyetjen e parë pyetja për sa i përket dhunimit të qytetarëve nga ana e kafshëve me pronar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam përshtypjen se ajo mund të jetë parashikuar në legjislacionin penal në një dispozitë tjetër.

Sigurisht, nëse kafsha ime dhunon një qytetar tjetër, sigurisht që unë mbaj përgjegjësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, nëse unë rrezikoj jetën e një qytetari nëpërmjet kafshës sime, të cilën unë e kam si një mjet, që mund t'i shkaktojë vdekjen atij...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, mund ta shtoni këtë.

Ulsi Manja – Kolegët thanë se kjo duhet t'i nënshtrohet një diskutimi shumë të gjerë edhe nga pikëpamja e përfshirjes së aktorëve të tjerë në diskutim, sepse këtu kemi sot nismëtarët, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë, por në fakt në diskutimin e mëtejshëm të kësaj nisme është shumë e rëndësishme të përfshihen edhe aktorët e tjerë, si Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Shërbimi Kombëtar Veterinar, sepse është shumë i vërtetë shqetësimi që ngriti zoti Luli. Ne sot kemi një mangësi në legjislacion për sa i përket sigurisë ushqimore, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së kafshëve.

Besoj se edhe nga pikëpamja e teknikës legjislative nisma a shumë për t'u përmirësuar e pse jo, edhe për t'u përafruar me standardet më të mira europiane.

Ju po sillni këtu praktika nga Gjermania, Franca, Austria, Italia, Danimarka, por është shumë e rëndësishme të dimë se si qëndron kjo nismë në raport me të gjithë kuadrin ligjor që kemi sot në fuqi. Pra, nuk po flas për ligjin penal, por po flas për legjislacionin dytësor ose primar, për sa u përket ministrive të linjës.

Kështu, në këtë kuptim, ne jemi sot vetëm për t'u shprehur në parim për këtë nismë. Pastaj, në fazat e tjera të konsultimit dhe të diskutimit do t'u lëmë të gjithë hapësirën e nevojshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por...

Jonel Kristo – Përgjigjja është se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ta mbaroj fjalën unë, zoti Fino dhe pastaj merr sa të duash përgjigje. Keni të drejtën të bëni pyetje dhe të diskutoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj fjalën unë, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mund ta përsëris 10 herë zoti Fino, se kam të drejtën time për të folur, ashtu siç e keni edhe ju këtë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju lutesha të fokusohemi vetëm në diskutimin në parim të kësaj nisme! Çështjet që kanë të bëjnë me çështje të teknikës legjislative apo të trajtimit nen për nen, apo të koncepteve që ka projektligji, nuk besoj se është vendi për t'i trajtuar sot.

Tani mund të vazhdoni t'i përgjigjeni zoti Fino edhe për pyetjet e tjera!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Bashkim Fino – Zoti kryetar,

Ju kërkoi ndjesë për ndërprerjen, por ju duhet ta drejtoni mbledhjen sipas procedurës së mbledhjes së komisionit!

Dëgjuam nismëtarët, institucionet përkatëse që ishin këtu, dëgjuam relatorin dhe më pas u vazhdua me pyetjet. Unë dhe disa kolegë bëmë pyetje.

Tani se çfarë forme janë pyetjet, pak rëndësi ka. Nëse këta që janë këtu, duan të na kthejnë përgjigje, le ta bëjnë. Nëse nuk e ndejnë të na kthejnë përgjigje, le të mos përgjigjen.

Më pas, do të vazhdojmë me diskutimin në parim. Ju sapo bëtë tani, një diskutim shumë të gjatë dhe shumë të drejtë.

Pas diskutimit në parim, të ndërpritet, sepse këtu do të vazhdojmë më tej me diskutimet e tjera nen për nen, por ju nuk mund të thoni (të më falni që po ju sugjeroj), që nuk mund të bëjnë vërejtje për nene të caktuara, mua më duket jonormale. Kështu që, na diktoni se si do t'i bëjmë ose si do të kthejnë këta përgjigje për pyetjet që bëjmë ne.

Të lutem, për procedurë, vazhdojeni mbledhjen sipas rendit të ditës që kemi.

Jemi në radhën e pyetjeve. Në qoftë se ka mbaruar pika e dytë e pyetjeve dhe ka filluar diskutimi në parim, të kërkoj ndjesë, tërhiqem përsëri.

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë nuk pata diskutim.

Fjala ime ishte për ta futur mbledhjen e Komisionit të Ligjeve në thelbin e diskutimit. Jemi në diskutimin në parim, jo në pyetje për nene të caktuara.

Kaq e thjeshtë ishte gjëja.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon)

Tani, sa për Rregullohen, nuk besoj se ka deputet në këtë tavolinë që nuk e di këtë parashikim të Rregullores dhe se si veprohet me një nismë ligjore.

Bashkim Fino – Atëherë, unë kërkoj për pyetjen që bëra të më kthehet përgjigje, se nuk duan të më kthejnë përgjigje...

Ulsi Manja – Bukur.

Bashkim Fino – ... edhe unë dua të jem në rregull. Por unë kam bërë një pyetje dhe dua një përgjigje.

Ulsi Manja – Patjetër, do të merrni përgjigje.

Bashkim Fino – Ose të më thonë: nuk kemi përgjigje, ose të më kthejnë një përgjigje.

Ulsi Manja – Patjetër.

Bashkim Fino – Ose të më thonë: duam kohë të mendohemi dhe të kthejmë përgjigje pas një jave, kur të mblidhemi përsëri. Është e drejta ime ta kërkoj një gjë të tillë.

Ulsi Manja – Patjetër.

Bashkim Fino – Të lutem! Kam bërë një pyetje, madje pyeta i pari, dhe nuk po marr ende përgjigje.

Të falënderoj!

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë e kuptoj shumë drejt qëndrimin tuaj.

Nisur nga fakti se nuk e kemi opozitën këtu, do të duhet dikush ta bëjë edhe opozitën, por e rëndësishme është që ky diskutim t'i shërbejë nismës.

Ka përgjigje për pyetjen e zotit Fino?

(Deputeti Fino flet pa mikrofon)

Zonja Hysi flet vetë.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon)

Fatmirësisht, zonja Hysi, është prezente.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon)

Indrit Osmani – Në lidhje me pyetjen që bëri zoti Fino, mund të sqaroj se ne nuk kemi qenë në dijeni në momentin kur kemi bërë draftin që, sipas legjislacionit shqiptar, nuk mund të vendosen dy dënime kryesore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nuk mund të ketë edhe gjobë, edhe dënim me burg.

Ne nuk kemi qenë në dijeni për këtë. Megjithatë, ju keni të gjithë të drejtën ta ndryshoni.

Në lidhje me pyetjen e fundit që bëri zonja Hysi, bëhet fjalë për nenin që parashikon ndeshjet ndërmjet kafshëve. Pra, bëhet fjalë për një nen, i cili parashikon ndeshjet e paligjshme ndërmjet kafshëve.

Cilido prej personave që merr pjesë në këto baste të paligjshme dhe cilido prej personave që publikon me qëllim reklamimin dhe nxitjen e këtyre basteve të paligjshme gjobitet. Pra, nuk bëhet fjalë që të gjobitet një televizion që jep një film me delfinë e të tjerë. por vetëm për pjesën kur ndeshjet ndërmjet kafshëve cilësohen si vepra penale. Ky nen ka pesë pika, ku njëra prej pikave është edhe kjo që dënohen edhe personat të cilët, gjithashtu, publikojnë me qëllim nxitjen e këtyre basteve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime? Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zotërinj!

Unë besoj se jemi në momentin e duhur për të filluar një iniciativë të tillë ligjore dhe ju falënderoj për nismën që keni ndërmarrë, të cilën e konsideroj të rëndësishme, duke pasur parasysh edhe faktin që dhuna duhet të jetë e dënueshme në të gjitha format e saj. Ajo fillon nga kafsha, por ne kemi raste tashmë të ditura se nga kafsha ka kaluar te njerëzit. Kështu që, në parim dëshiroj të shpreh mbështetjen time, por, me sa kuptova, edhe kolegët tanë këtu janë pro mbështetjes së nismës suaj. Sigurisht, në shqyrtimin e kësaj nisme nen për nen, edhe të teknikës legjislative, do të përpiqemi ta marrim sa më shumë parasysh këtë që ju propozoni, por sigurisht do të mund të bëjmë edhe ndërhyrje apo ndryshime të tjera për të qenë me një

produkt, i cili të përfaqësojë sa më mirë interesat e qytetarëve dhe të kafshëve në momentin në të cilat ne ndodhemi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

E hedhim në votim në parim. Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (nismë e 37527 zgjedhësve)? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Siç e thashë edhe pak më parë, ky projektligj do t’i nënshtrohet një diskutimi të gjerë edhe me aktorë të tjerë. Relatori së bashku me këshilltarët e komisionit të marrin masat e duhura për të organizuar ndoshta edhe tryeza konsultimi dhe diskutimi në lidhje me këtë projektligj.

Dua ta vë në dijeni komisionin se Komisioni për Sigurinë Kombëtare, si komision për dhënie mendimi, e ka shqyrtuar dhe miratuar nismën, si dhe ka sjellë edhe mendimin për komisionin tonë, i cili do t’u vihet në dispozicion relatorit, këshilltarëve dhe përfaqësuesve të tjerë që do të përfshihen në diskutimin e këtij projektligji.

Ju uroj një ditë të mbarë dhe ju falënderoj, njëkohësisht, për prezencën sot në komision, si dhe për këtë nismë të mirë që prezantuat në komisionin tonë.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi – drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mamica Dhamo – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nada Dollani – eksperte e GIZ-it

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Alket Hyseni.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zoti Elton Haxhi, zëvendësministër; zonja Majlinda Hafizi, drejtoreshë; zonja Mamica Dhama, specialiste, dhe zonja Nada Dollani, eksperte e GIZ-it.

Ju lutem, zini vendet!

Zoti Hyseni, përpara se të fillojmë me diskutimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji, besoj se keni zhvilluar më parë takime me grupin e punës dhe jeni dakordësuar për projektligjin. Si do të procedojmë?

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Gjej rastin të falënderoj edhe ekspertët që kanë punuar për këtë projektligj, sepse ka pasur kontakte edhe me këshilltarët e Kuvendit, edhe me ekspertët, edhe me mua dhe kemi rakorduar për të ardhur me disa përmirësime kryesisht të teknikës legjislative, të cilat kanë synuar në thelb të jenë strikte me aktet komunitare të Bashkimit Europian. Ndryshimet kanë bërë rregullime të teknikës legjislative, por në thelb jemi para një projektligji të punuar mjaft mirë. Ftoj kolegët që, pasi të njihen me përmirësimin e drafteve të të paktën 25 neneve, të na bashkohen në miratimin e këtyre ndryshimeve.

Ulsi Manja – Atëherë, vazhdojmë.

Zoti Haxhi, do të duhet të shprehni qëndrimin tuaj, si ministri, për secilin nen. Kështu që fillojmë me nenin 1.

Ka vërejtje nga relatori për nenin 1?

(Diskutime në sallë)

Ju lutem, më ndiqni nen për nen.

Alket Hyseni – Shprehemi dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shtypeni mikrofonin.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Edhe një herë, biem dakord me nenin 1, me ndryshimet që propozohen nga relatori?

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Biem dakord me nenin 2, me ndryshimet që propozohen?

Alket Hyseni – Shprehemi dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3, për të cilin nuk ka ndryshime. Kush është pro? Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Vazhdojmë me nenin 4, për të cilin gjithashtu nuk ka...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Hyseni.

(Deputeti Hyseni flet pa mikrofon.)

Jeni pro? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Neni 5?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ministria?

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7, me ndryshimet që propozon relatori.

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Biem dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8, me ndryshimet që propozon relatori. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9.

Alket Hyseni – Shprehem dakord me ndryshimet.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10, me ndryshimet e propozuara nga relatori.

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Neni 12, me ndryshimet e propozuara. Bini dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Dakord edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 12.

Kalojmë te neni 13. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Neni 14, me ndryshimet e propozuara nga relatori. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 14.

Kalojmë te neni 15, me ndryshimet e propozuara. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Kalojmë te neni 16, me ndryshimet që propozon relatori. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17. Relatori?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Ulsi Manja – Ministria, dakord?

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 17.

Neni 18, me ndryshimet e propozuara.

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 18.

Kalojmë te neni 19.

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Biem dakord me nenin 19, me ndryshimet e propozuara?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 19.

Kalojmë te neni 20, me ndryshimet e propozuara. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22, me ndryshimet e propozuara. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 22, me ndryshimet e propozuara.

Kalojmë te neni 23. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 24. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25 “Dispozita kalimtare”. Biem dakord?

Alket Hyseni – Shprehem dakord.

Elton Haxhi – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Zonja Hysi kërkon fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, shumë faleminderit për të gjitha përmirësimet që i bëni këtij ligji. Ndryshimet janë të shumta dhe unë kam një pyetje për propozuesit. Në dispozitën kalimtare jeni shprehur vetëm për krijimin e strukturës përgjegjëse, e cila do të zgjidhë me alternativë mosmarrëveshjet që ekzistojnë ndërmjet konsumatorit dhe palëve të tjera. Por nga i gjithë leximi i projektligjit unë shoh që ka nevojë edhe për akte nënligjore, apo gjithçka do të rregullohet me aktet nënligjore në fuqi?

Nëse po, pse nuk janë parashikuar në këtë dispozitë kalimtare?

Së dyti, me këtë projektligj, me një nen shtohen shumë nene, 5, 6 në disa raste edhe 10. Pra, ligji pëson një ndryshim gati 50% të tij, pavarësisht se si numër nenesh duket sikur janë pak. Si është menduar të gjejë zbatim të mirë ky ligj dhe të mbrojë realisht të drejtat e konsumatorit? Flas gjithmonë në lidhje me dispozitën kalimtare. Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, në nenin 25, duke parë edhe sugjerimin e bërë nga relatori, duhet që pas këtij neni të shtohet një nen i ri ku të përcaktohet nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, si dhe afati për daljen e këtyre akteve.

Ka një propozim konkret për këtë?

Alket Hyseni - Neni 26, zoti kryetar, thotë: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit”. Është e mjaftueshme?

Ulsi Manja - Në fakt, duhet formulim konkret për nenin e ri që propozojmë për komisionin përgjegjës. Do të duhet ta formulojmë saktësisht nenin përkatës për nxjerrjen e akteve ligjore dhe me afat konkret.

Nëse relatori dhe propozuesit marrin përsipër të bëjnë një formulim lidhur me...

Elton Haxhi - Mund të bëj një sqarim? Në nenin 52/6, pika 3, citohet: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të strukturës përgjegjëse që përcaktohet në pikën 2”.

Vasilika Hysi – Zoti Zëvendësministër, e pashë këtë nen dhe si rregull në dispozitën kalimtare, që relatori me të drejtë e ka ngritur si një sugjerim, kemi detyrim kushtetues të parashikojmë çdo detyrim që buron nga miratimi i këtij ligji. Pra, në qoftë se një paragraf ka një risi, e cila nuk rregullohet me aktet nënligjore në fuqi, duhet thënë se cili është autoriteti përgjegjës që duhet ta nxjerrë llojin e aktit dhe afatin. Është kërkesë kushtetuese.

Mendoj se nga leximi i projektligjit ka disa akte nënligjore. Ç’do të bëhet me aktet nënligjore, të cilat janë në fuqi dhe bien ndesh me këtë ligj? Deri kur do të veprojnë, sepse ju thoni që ligji do të hyjë në fuqi brenda 15 ditëve. Po me aktet ligjore që bien ndesh, a do të vihet një dispozitë që aktet nënligjore në fuqi do të zbatohen për aq kohë sa nuk bien ndesh me të? Ndërkohë bëni listimin, që unë them se nuk mund ta bëjmë dot sot, por duke u ulur bashkë me relatorin dhe duke e marrë ligjin një për një, ju që i njihni se cilat janë aktet ligjore që do të qëndrojnë dhe cilat janë aktet e reja që nuk janë, por do të dalin, përcaktoni edhe autoritetin përgjegjës, përndryshe ky ligj do të mbetet në letër për muaj të tërë, e megjithëse thoni se do të hyjë në fuqi brenda 15 ditëve, nuk ka për t’u zbatuar. Aq më tepër që kemi detyrimin që, kur shqyrtojmë një projektligj me kaq shumë ndryshime, paralelisht deputetët duhet të njihen edhe me paketën e akteve nënligjore, pavarësisht se miratohen nga Këshilli i Ministrave ose nga ministrat përgjegjës. Ne nuk e kemi marrë paketën, por kjo mund të bëhet, sepse me të drejtë kryetari i komisionit i ka lënë detyrë dhe i ka kërkuar Këshillit të Ministrave që ligjet të vijnë bashkë me paketën e akteve nënligjore. Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Majlinda Hafizi - Faleminderit, profesoreshë Vasilikës!

Janë transpozuar dy direktiva me projektndryshimet. Për sa i përket njëres direktivë, ajo është transpozuar e plotë dhe nuk ka nevojë për asnjë akt nënligjor. E vetmja gjë është se ajo do të shfuqizojë dy akte nënligjore, vendime të Këshillit të Ministrave që ishin rregulluar sipas dispozitave të vjetra, që flitet për kontratat në largësi dhe kontratat jashtë qendrave të tregtimit. Ato dy VKM nuk mund të operojnë më me miratimin e këtij ligji, sepse bien ndesh.

Ndërsa, për sa i përket direktivës tjetër, që ka të bëjë me zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve me konsumatorët, sigurisht që duhet bërë një parashikim i qartë për mënyrën sesi do të funksionojë struktura që do të merret me këto mosmarrëveshje. Kryesisht nuk kanë nevojë, prandaj ligji është kaq i gjerë. Ligji rregullon marrëdhëniet midis palëve private, kështu që është shumë mirë që gjendet në një ligj dhe jo në VKM. Tregtarët asnjëherë nuk i shikojnë VKM-të ose nuk mendojnë se janë të detyruar nga ato. Kështu që do të ketë shumë pak VKM, vetëm ato që do të merren me strukturat administrative.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Fjala për zotin Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Kam një pyetje të drejtpërdrejtë, jam në një linjë me relatorin. Relatori ka bërë një material shumë të mirë dhe e falënderoj, ku thuhet: “Pas nenit 25 shtohet një nen i ri ku thuhet: “Aktet nënligjore nxirren nga Këshilli i Ministrave”. Çdo ligj që kemi miratuar, me historikun dhe vjetërsinë që kemi ne, ka një nen të caktuar kur aktet nënligjore nxirren nga Këshilli i Ministrave apo edhe nga ministri përkatës.

E vetmja gjë që ka lënë me pikëpyetje relatori është afati se sa do të jetë kjo periudhë, 2 muaj, 3 muaj apo 6 muaj, gjë e cila duhet konsultuar me Ministrinë e Financave.

Ne, zoti kryetar, sapo e kaluam dhe thamë që duhet të vëmë një nen të ri, për të cilin ramë të gjithë dakord që ia sugjeruam Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës. Ky ligj duhet të vihet se s’bën, pak rëndësi ka se sa akte nënligjore do të dalin, 1, 2 apo mund të mos dalë asnjë. Do të dalë ndoshta një urdhër ministri, si akt nënligjor, dhe do të dalë në funksion të këtij ligji, edhe po doli. Kështu që ky nen duhet vendosur dhe duhet përcaktuar edhe afati, për mendimin tim. Faleminderit!

Ulsi Manja – Dakord me sugjerimin e kolegut Fino për nenin 25. Pra, duhet të kemi një nen të ri lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore. Çështja e afatit është lënë e hapur. Gjykojmë si komision që të përcaktojmë një afat dhe t’ia sugjerojmë komisionit përgjegjës, pavarësisht se nuk e dimë natyrën e akteve nënligjore që do të duhet të dalin në zbatim të këtij ligji.

Alket Hyseni - Mendoj t'ia kalojmë si sugjerim të përgjithshëm Komisionit të Ekonomisë, ndërkohë t'u lëmë kohë ministrisë dhe ekspertëve të specifikojnë momentet se ku kërkohet të ndërhyhet me akte nënligjore dhe të konsultojnë edhe çështjen e afatit, që mendoj se do të jetë i arsyeshëm në rendin e 6 muajve për ta bërë të mundur që ligji të mos zvarritet në kohë. Megjithatë, do të jetë ministria që do të na e sugjerojë këtë dhe le ta kalojmë në parim në këtë formë, si sugjerim për shtimin e një neni.

Ulsi Manja – Duke qenë se ne nuk e dimë natyrën e akteve nënligjore që do të duhet të dalin në zbatim të këtij ligji, t'ia delegojmë komisionit përgjegjës që është në kontakt edhe me ministritë e linjës për të përcaktuar gamën e akteve që do të dalin dhe afatin brenda të cilit do të dalin këto akte nënligjore. Është detyrim kushtetues që në këtë projektligj të kemi një nen lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave dhe afatin konkret.

Pra, jeni dakord me nenin 25 me propozimin e relatorit lidhur me sugjerimin e bërë për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe afatin për komisionin përkatës? Dakord! Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26 “Hyrja në fuqi”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 26.

E hedhim në votim në tërësi këtë projektligj.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”. Ky projektligj së bashku me relacionin përkatës t'i kalojë komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare.

Me miratimin në tërësi të këtij projektligji mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Ditë të mbarë! Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

